Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Në veçanti, elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare lidhen me rivlerësimin e tokës dhe ndërtesës dhe aktiveve afatgjata materiale të investuara me vlerën e drejtë.

(e) Ndryshime në politikat kontabël

Duke filluar që nga 1 Janari 2010, Shoqëria ka ndryshuar formën e raportimit bazuar në SNRF duke adaptuar ndryshimet që sjellin këto të fundit. Ndryshimet paraqiten në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse. Ndryshimi në politikën kontabël prek vetëm aspektin prezantues të pasqyrave financiare.

3. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

(a) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Toka dhe ndërtesat përfshijnë zyrat dhe Qendrat e Kontrollit Teknik. Toka dhe ndërtesa paraqiten me vlerën, duke zbritur amortizimin për ndërtesën. Rivlerësimi i aseteve nuk aplikohet, pasi kontrata e konsensionit është me afat 10 Vjecar, teknologjia e përdorur është e sapoinvestuar duke mos patur indikacione në treg për ndryshime në vlera si dhe nga klauzola e kesaj kontrate për ta dorezuar aktivitetin në fund të afatit “ashtu sic është pa të drejtë shperblimi”.

Ndertesat aktuale janë rikonstruktuar. Vlera e trashëguar e ndërtesave ekzistuese nuk është paraqitur në PF e 2010 pikërisht për të njëjten klauzole kontrate që përmendëm më sipër. Në pasqyrat e 2009, këto vlera janë të përfshira, por në 2010 ato janë ekstrakontabël dhe informacioni mbi to do merret nga tabela statistikore mbi vlerën e tyre dhe amortizimin që do shoqërojnë këtë raport.

Kostoja e rikonstruksionit ka të bëjë me koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, e faturuar kjo nga nenkontraktori kryesor.



Fitimet dhe humbjet nga shitja e një aktivi afatgjatë material përcaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivit afatgjatë material, dhe njihen në fitim ose humbje.

(ii) Amortizimi

Amortizimi nuk llogaritet për tokën dhe ndërtimet në proces. Amortizimi i Ndertesave është 10 % bazuar në jetegjatesinë e kontrates së koncensionit dhe klauzoles për dorezimin e biznesit në fund të 10-viteve “ashtu sic është” duke shpërndarë në mënyrë të drejtë koston për vitet efektive të përdorimit për qëllimin e aktivitetit. Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare si vijon:

Ndërtesa	10%
Instalime teknike	20%
Automjete	20%
Instalime IT dhe EDP Hardware	33.30%
Mobilje dhe orëndi	20%

Për efekt të llogaritjes së Shpenzimit Tatimore, njihen fiskalisht shpenzimet për amortizim sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

(b) Aktive afatgjata jo-materiale

Aktivet afatgjata jo-materiale përfshijnë programin kompjuterik të blerë nga Shoqëria. Aktivet afatgjata jo-materiale njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin e akumuluar. Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën e zvogëlimit të tepricës. Programi kompjuterik është amortizuar me një normë vjetore prej 33.3%.

(c) Aktivet e marra me qira

Qiratë janë qira të zakonshme dhe operacionale për të cilat aktivi i marrë me qira nuk njihet në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë.

(d) Inventarët

Inventarët maten me vlerën më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarëve bazohet në parimin e mesatares së ponderuar dhe përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e shndërrimit dhe kosto të tjera që lidhen me vënien e inventarëve në vendin dhe kushtet aktuale. Artikulli kryesor inventarial është Certifikata e cila shërben për rezultatin që leshohet nga testimi i mjeteve në Shqipëri.

Nr	Përshkrimi	Nr I Llogarise	Gjendja në 31.12.2010	Gjendja në 31.12.2009
1	Materiale të tjera	312	2,076,221	
2	Inventar I imet	32	1,818,079	1,588,493
	Totali		3,894,300	1,588,493

(e) Instrumentet financiarë

Shoqëria mban vetëm instrumente financiarë jo-derivativë, që përfshijnë mjete monetare dhe ekuivalente me to, llogari të arkëtueshme, llogari të pagueshme, kredi dhe hua. Instrumentet financiarë jo-derivative janë matur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumenta jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e



transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre. Njohja në vijim e instrumenteve financiarë jo-derivativë përshkruhet më poshtë.

Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë dhe llogari rrjedhëse në banka. Gjendjet në monedhe të huaja mbahen në limite minimale në mënyrë që të evitohet risku financiar nga luhajtjet e kurseve të këmbimit.

Kërkesa për arkëtim

Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar të pakësuara për humbjet për zhvlerësime.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar.

Hua dhe kredi

Shoqëria ka kredi afatshkurter dhe afatgjate të leshuar nga ortakët e vetëm SGS SA. Këto borxhe vijnë si pasoje e detyrimit kontraktual për të mbaruar të gjithë rikonstruksionin dhe obligimet që lidhen me të në harkun e një vjeçar.

Në vijim të njohjes fillestare, huatë dhe kreditë paraqiten me kosto të amortizuar me ndonjë diferencë ndërmjet koston dhe vlerës së riblerjes që njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjes në bazat e interesit efektiv.

Kapitali aksioner

Kapitali aksioner i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

(f) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat gjenerohen vetëm nga shërbimi i kontrollit teknik të automjeteve.

(g) Përfitimet e punonjësve

Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Qeveria Shqiptare është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

Leje vjetore të paguara

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhen në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës.



Bonuset

Bonuset njihen dhe paguhen per Drejtorin e pergjithshem dhe manaxheret qe raportojne direkt tek ai bazuar ne kontraten e tyre individuale te punes.

Bonuset paguhen bazuar ne performancen e kompanise, rajonit por edhe ate personale ne Mras te vitit pasardhes.

(h) Pagesat e qirasë

Pagesat e kryera për qiranë e zakonshme janë ngarkuar në fitim ose humbje në mënyre lineare gjatë periudhës së qirasë.

Shpenzimet financiare janë shpërndarë për çdo periudhë gjatë afatit të qirasë në mënyrë që të japin një normë interesi periodike dhe konstante mbi pjesën e mbetur të detyrimit.

(i) Të ardhura dhe shpenzime financiar

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga llogaritë në banka dhe fitimet nga kursi i këmbimit që njihen në fitim ose humbje. Të ardhurat nga interesi njihen kur ai përfitohet duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Të gjitha kostot e huave njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(j) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin ose humbjen e vitit përfshin tatimin e periudhës aktuale. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

(l) Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje, përveç diferencave që rrjedhin nga konvertimi i instrumenteve të kapitalit të vlefshme për shitje (nëse ka), të cilat njihen në të ardhura të tjera përmbledhëse.

(k) Parimi i vijueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijueshmërisë, i cili supozon realizimin e aktiveve dhe përmbushjen e detyrimeve në rrjedhën normale të biznesit.



3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(l) Standarte te aplikueshme

Pasqyrat Financiare te shoqërise jane ndertuar duke u bazuar ne KIRFN 12 *Marrëveshjet Koncensionare të Shërbimit* u zhvillua nga Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve për raportimin financiar dhe u nxorr nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në nëntor 2006.

Ky Interpretim zbatohet për Marrëveshjet Koncensionare të Shërbimit publik- privat nëse: koncensiondhënësi kontrollon ose rregullon se çfarë shërbimesh të infrastrukturës duhet të kryejë operatori, kujt duhet t'ia kryejë ato dhe me çfarë çmimi; dhe koncensiondhënësi kontrollon—nëpërmjet pronësisë, titullit për përfitim ose në një formë tjetër—çdo interes të konsiderueshëm të mbetur në infrastrukturë në fund të afatit të marrëveshjes.

Infrastruktura e përdorur në marrëveshjen e koncensionit për shërbimet publik- privat për tërë jetën e dobishme të saj (gjithë jetën e aktiveve) përbën objekt të këtij Interpretimi nëse plotësohen kushtet e dhëna në paragrafin 5(a). Paragrafët AG1–AG8 japin udhëzimin për të caktuar nëse dhe në çmasë marrëveshjet e koncensionit për shërbime publik-privat përbëjnë objekt të këtij Interpretimi. Ky Interpretim zbatohet si për: infrastrukturën që operatori ndërton ose blen nga një palë e tretë në kuadrin e marrëveshjes së shërbimit; dhe për (b) infrastrukturën ekzistuese për të cilën koncensiondhënësi i jep operatorit të drejtën e përdorimit për qëllime të marrëveshjes së shërbimit. Ky Interpretim nuk specifikon trajtimin kontabël për infrastrukturën që zotërohet dhe njihet si toka, ndërtesa, makineri e pajisje nga operatori para hyrjes në marrëveshjen e shërbimit. Për këtë infrastrukturë zbatohen kërkesat për çregjistrim të SNRF-ve (të trajtuara në SNK 16).

(m) Standarde dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara

Në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, Standarde të reja, Interpretime të Standardeve dhe rishikime të Standardeve si më poshtë janë publikuar por nuk janë bërë ende efektive dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare:

- Rishikimi i SNRF 2 *Pagesat e Bazuara në Aksione* – Transaksionet e pagesave të bazuara në aksione për t'u shlyer në mjete monetare brenda grupit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2010 ose më pas). Rishikimet e standardit kërkojnë që një njësi ekonomike e cila merr mallra ose shërbime nëpërmjet pagesave bazuar në aksione që janë shlyer në mjete monetare ose aktive të tjera nga një njësi tjetër ekonomike brenda grupit ose nga një pronar i kësaj njësie ekonomike, të njohë mallrat ose shërbimet e përfituara në pasqyrat financiare. Më parë transaksionet e pagesave të bazuara në aksione për t'u shlyer në mjete monetare brenda grupit nuk adresoheshin direkt në SNRF 2. Rishikimet e SNRF 2 nuk janë relevante për pasqyrat financiare të Shoqërisë sepse Shoqëria nuk ka një plan kompensimi me pagesa bazuar në aksione.
- Rishikimi i SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2009 ose më pas). Objekti i standardit të rishikuar është rritur dhe përkufizimi i biznesit është zgjeruar. Standardi i rishikuar përfshin gjithashtu një numër ndryshimesh të tjera duke përfshirë:

(o) Standarde dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara (vazhdim)

- Të gjithë elementët e shumës së paguar nga blerësi njihen dhe maten me vlerën e drejtë në datën e blerjes, duke përfshirë shumat e kushtëzuara.
- Ndryshime të mëtejshme në shumat e kushtëzuara do të njihen në fitim ose humbje.
- Blerësi mund të zgjedhë të masë interesat e pakicës me vlerën e drejtë në datën e blerjes (emri i mirë i plotë), ose interesin e tij proporcional në vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të identifikuar të shitësit, mbi bazë transaksion pas transaksioni.

SNRF 3 i rishikuar nuk është relevant për pasqyrat financiare të Shoqërisë duke qenë se Shoqëria nuk ka ndonjë interes në filiale që do të ndikohen nga rishikimi i këtij Standardi.



- SNRF 9 *Instrumentat Financiare* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 ose më pas, aplikimi i hershëm është i lejuar). Ky standard zëvendëson udhëzimet në SNK 39, *Instrumentat Financiare: Njohja dhe Matja*, në lidhje me klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Standardi eliminon kategoritë ekzistuese në SNK 39 për iaktivet financiare të mbajtur deri në maturim, të gatshëm për shitje dhe hua dhe të arkëtueshme. Aktivet financiare do të klasifikohen në njërin nga dy kategoritë në njohjen fillestare:
 - aktive financiare të matur me koston e amortizuar; ose
 - aktive financiare të matur më vlerën e drejtë.

Një aktiv financiar mund të matet me koston e amortizuar nëse plotësohen kushtet e mëposhtme: aktivi mbahet brenda një modeli biznesi objektiv i të cilit është që të mbajë aktivet për të mbledhur flukset monetare sipas termave kontraktuale; dhe, sipas termave kontraktuale rrjedhin flukse monetare në data të përcaktuara që janë pagesa të principarit dhe interesit mbi principalin e papaguar në fund të periudhës.

Fitimet ose humbjet nga rimatja e aktiveve financiare me vlerë të drejtë njihen në fitim ose humbje, përveç rastit të një instrumenti investimi në kapital që nuk është mbajtur për tu tregtuar, për të cilin SNRF 9 parashikon një zgjedhje definitive në njohjen fillestare për të paraqitur të gjitha ndryshimet nga vlera e drejtë e investimit në të ardhura të tjera përmbledhëse. Zgjedhja është e disponueshme në bazë të çdo aksioni individual. Asnjë shumë e njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse nuk mund të rriklassifikohet në fitim ose humbje në një datë të mëvonshme.

Nuk pritet që SNRF 9 do të ndikojë në mënyrë të rëndësishme pasqyrat financiare të Shoqërisë sepse nisur nga natyra e aktiviteteve të Shoqërisë dhe llojet e aktiveve financiare që ajo mban, nuk pritet që klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare të ndryshojë në mënyrë të rëndësishme sipas SNRF 9.

- Rishikimi i SNK 24 *Dhënia e informacioneve shpjeguese për Palët e Lidhura* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2011 ose më pas). Rishikimi përjashton njësitë ekonomike të lidhura me qeverinë nga kërkesat për dhënie të informacioneve shpjeguese në lidhje me transaksionet dhe gjenden në fund të periudhës për palët e lidhura, duke përfshirë angazhimet me (a) një qeveri e cila ka kontroll, kontroll të përbashkët ose influencë të konsiderueshme mbi njësinë ekonomike raportuese; dhe (b) një njësi tjetër ekonomike e cila është palë e lidhur sepse e njëjta qeveri ka kontroll të përbashkët ose influencë të konsiderueshme mbi të dyja, njësinë ekonomike raportuese dhe njësinë tjetër.

(o) Standarde dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara (vazhdim)

Standarti i rishikuar kërkon dhënie të informacioneve shpjeguese specifike nëse një njësi ekonomike përdor avantazhin e këtij përjashtimi. Standarti i rishikuar gjithashtu zgjeron përkufizimin e palëve të lidhura e cila rezultoi në përfshirjen e marrëdhënieve të tjera, të tilla si, ortakët e aksionerit që ka kontrollin dhe njësitë ekonomike të kontrolluara ose në kontroll të përbashkët nga personeli drejtues kryesor. Rishikimi i SNK 24 nuk është relevant për pasqyrat financiare të Shoqërisë sepse Shoqëria nuk është një njësi ekonomike e lidhur me qeverinë dhe përkufizimi i rishikuar i palëve të lidhura nuk pritet të rezultojë në marrëdhënie të reja që kërkojnë dhënie të informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare.

- Rishikimi i SNK 27 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2009 ose më pas). Në standardin e rishikuar shprehja interes i pakicës është zëvendësuar me interes jo-kontrollues, dhe është përcaktuar si “kapitali në një filial që nuk i atribuohet në mënyrë direkte ose të tërthortë shoqërisë mëmë”. Standardi i rishikuar gjithashtu ndryshin kontabilizimin për interesat jo-kontrollues, humbjen e kontrollit në një filial, dhe alokimin e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse ndërmjet interesave kontrollues dhe jo-kontrollues. Rishikimi i SNK 27 nuk është relevant për pasqyrat financiare të Shoqërisë sepse Shoqëria nuk ka interesa në filiale që do të ndikoheshin nga rishikimi i standardit.
- Rishikimi i SNK 32 *Instrumentet Financiare: Paraqitja – Klasifikimi i të Drejtave* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 shkurt 2010 ose më pas). Rishikimi kërkon që të drejtat, opsionet ose garancitë për blerjen e një numri të caktuar të instrumentave të kapitalit të vetë shoqërisë për një shumicë të caktuar në çfarëdo



monedhe, të njihen si instrumenta kapitali nëse shoqëria ia ofron të drejtat, opsionet ose garancitë në mënyrë proporcionale të gjithë pronarëve ekzistues të së njëjtës kategori të instrumentave jo-derivativë të kapitalit të vet. Rishikimet e SNK 32 nuk janë relevante për pasqyrat financiare të Shoqërisë sepse Shoqëria nuk ka emetuar instrumenta të tillë në të shkuarën.

- Rishikimi i SNK 39 *Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja – Elementët e Mbrojtur të Pranueshëm* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Korrik 2009 ose më pas). Standardi i rishikuar sqaron aplikimin e parimeve ekzistuese që përcaktojnë nëse rreziqe specifike ose pjesë të flukseve monetare janë të pranueshëm të përcaktohen në një marrëdhënie mbrojtje “hedging”. Në përzgjedhjen e një marrëdhënie mbrojtje rreziqet duhet të jenë të identifikueshëm në mënyrë individuale dhe të matshëm me besueshmëri; megjithatë inflacioni nuk mund të përzgjidhet, përveç në rrethana të kushtëzuara. Rishikimet e SNK 39 nuk janë relevante për pasqyrat financiare të Shoqërisë sepse Shoqëria nuk e aplikon kontabilitetin mbrojtës.
- SNRF për Shoqëritë e vogla dhe te mesme (SME), e cila nuk ka një datë efektive; por që mund të hyjë në fuqi nga një datë e vendosur nga entet rregullatore kombëtare në çdo juridiksion. SNRF për SME është menduar të thjeshtëzojë raportimin financiar për njësitë e vogla dhe të mesme të cilat kërkojnë të aplikojnë standarte ndërkombëtare, duke ofruar një politikë kontabël të përshtatshme për to. Është një variant i reduktuar dhe i thjeshtuar i SNRF-ve të plota dhe është i disponueshëm për shoqëritë të cilat nuk kanë përgjegjësi publike. Do të jetë kuadri rregullator dhe legjislativ i çdo vendi që do të përcaktojë se cili entitet lejohet apo kërkohet të aplikojë SNRF për SME. SNRF për SME thjeshtëzon kërkesat për njohjen dhe matjen në disa fusha të caktuara krahasuar me SNRF-të e plota dhe përjashton çështje që konsiderohen si jo relevante për SME-të dhe gjithashtu eliminon opsionet më komplekse në disa fusha ku SNRF-të e plota lejojnë më shumë se një opsion kontabël.

(o) Standarde dhe interpretime të reja ende të pa-adoptuara (vazhdim)

Një entitet ose ndjek plotësisht kërkesat e SNRF për SME ose aplikon SNRF-të e plota. Ndryshimi vetëm është se një entitet që aplikon SNRF për SME mund të zgjedhë për instrumentat financiarë të zbatojë kërkesat e SNRF për SME, ose kërkesat për njohjen dhe matjen sipas SNK 39 *Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja* dhe kërkesat për shënimet shpjeguese të SNRF për SME.

Shoqëria plotëson kushtet si një entitet pa përgjegjësi publike; megjithatë drejtuesit janë në varësi të kërkesave që mund të parashtrijnë rregullat lokale dhe nuk kanë vendosur ende nëse do të aplikojnë SNRF për SME.

- Rishikimi i KIRFN 14 *SNK 19 – Limiti i një Aktivit për Përfitime të Përcaktuara, Kërkesat Minimale për Financim dhe Bashkëveprimi i tyre* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2011 ose më pas). Rishikimi i KIRFN 14 adreson trajtimin kontabël për parapagimet e bëra kur ka një kërkesë për minimumin e financimeve. Sipas rishikimit, një njësi ekonomike është e detyruar që të njohë disa parapagime si aktive me kushtin që njësi ekonomike të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga parapagimi në formën e flukseve monetare të reduktuara në të ardhmen ndërkohë që do të kërkoheshin pagesa për financim. Rishikimet e KIRFN 14 nuk janë relevante për pasqyrat financiare të Shoqërisë sepse Shoqëria nuk ka një plan për përfitime të përcaktuara me kërkesa për financime minimale.
- KIRFN 17 *Shpërndarja e Aktiveve jo-monetare Pronarëve* (efektive në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më 15 korrik 2009 ose më pas). Interpretimi aplikohet për shpërndarjen jo-reciproke të aktiveve jo-monetare ndaj pronarëve që veprojnë në kapacitetin e tyre si pronarë. Në përputhje me interpretimin, një detyrim për të paguar dividend duhet të njihet kur dividendi është autorizuar siç duhet dhe duhet të matet me vlerën e drejtë të aktiveve që do të shpërndahen. Vlera kontabël e dividendit të pagueshëm duhet të vlerësohet në çdo datë raportimi, dhe ndryshimet në vlerën kontabël të njihen në kapital si korigjim i vlerës për shpërndarje. Kur dividendi i pagueshëm shlyhet, diferenca (nëse ka) midis vlerës kontabël të aktiveve të shpërndara dhe vlerës kontabël të dividendëve të pagueshëm do të njihet në fitim ose humbje. Duke qënë se interpretimi është i aplikueshëm vetëm nisur nga data e caktuar për aplikim, ai nuk do të ketë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare për periudhat përpara datës së aplikimit. Gjithashu, duke qënë se ai lidhet me



dividentët të cilët vendosen nga bordi i drejtorëve/aksionerëve, nuk është e mundur që të përcaktohen efektet e aplikimit më përpara.

- KIRFN 19 *Heqja e Detyrimeve Financiare me Instrumentat e Kapitalit* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 ose më pas). Interpretimi sqaron se instrumentat e kapitalit të emtuara për një kreditor për të hequr të gjithë ose pjesërisht detyrimin financiar për një 'borxh për kapitalin sëap' konsiderohen të paguara sipas SNK 39.41. Matja fillestare e instrumentave të kapitalit të emtuar për të hequr një detyrim financiar bëhet me vlerën e drejtë e këtyre instrumentave, përveç nëse vlera e drejtë nuk mund të matet me besueshmëri, dhe në këtë rast instrumenti i kapitalit duhet të matet për të reflektuar vlerën e drejtë të detyrimit financiar të hequr. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar (ose pjesë e detyrimit financiar) të hequr dhe matjes fillestare të instrumentit të kapitalit të emtuar duhet të njihet në fitim ose humbje. Shoqëria nuk ka emtuar kapital për të hequr ndonjë detyrim financiar gjatë periudhës aktuale. Rrjedhimisht, interpretimi nuk do të ketë ndikim në shumat krahasuese në pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010. Për më tepër, duke qenë se interpretimi mund të bazohet vetëm në transaksione të cilat do të ndodhin në të ardhmen, nuk është e mundur që të përcaktohen efektet e aplikimit më përpara.



4. Aktive afatgjata materiale


Aktivet afatgjata materiale më 31 Dhjetor 2010 dhe 2009 përbëhen nga sa më poshtë:

Kosto	Toka	Ndertesa	Instalime		Totali
			Teknike	Te tjera	
Gjendja me 1 Janar 2009	0	0	0	0	0
Riklasifikime ne aktive afatgjata jo materiale	0	0	0	0	0
Shtesa / Pakesime	183,240,400	0	35,005,949	12,748,788	230,995,137
Amortizimi ne 2009	-	0	0	-489,806	-489,806
Gjendja më 31 dhjetor 2009	183,240,400	0	35,005,949	12,258,982	230,505,331
Shtesa / Pakesime	0	193,171,053	168,428,978	43,316,619	404,916,649
Riklasifikime ne aktive afatgjata jo materiale	0	0	0	0	0
Amortizimi ne 2010	-	-7,960,128	-13,732,084	-7,048,133	-28,740,345
Gjendja më 31 dhjetor 2010	183,240,400	185,210,925	189,702,843	48,527,468	606,681,635

5. Aktivet afatgjata jo materiale

Aktivet afatgjata jo-materiale më 31 dhjetor 2010 dhe 2009 përbëhen nga sa më poshtë:

Kosto	Program		Total
	Kompjuterik	Total	
Gjendja me 1 Janar 2009	0	0	0
Riklasifikime ne aktive afatgjata jo materiale	0	0	0
Shtesa / Pakesime	0	0	0
Amortizimi ne 2009	-	-	0
Gjendja më 31 dhjetor 2009	0	0	0
Shtesa / Pakesime	14,467,864	14,467,864	14,467,864
Riklasifikime ne aktive afatgjata jo materiale	0	0	0
Amortizimi ne 2010	-1,850,055	-1,850,055	-1,850,055
Gjendja më 31 dhjetor 2010	12,617,809	12,617,809	12,617,809



6. Kërkesa për arkëtim nga debitorët

Kërkesa për arkëtim më 31 dhjetor 2010 dhe 2009 përbëhen nga sa më poshtë:

	31-Dec-10	31-Dec-09
Garanci per Qera	243.000	243.000
Parapagime	24,280,253	5,864,997
Tatimi I parapaguar		36.000
TVSH per tu marre	40,076,173	8,214,949
Kërkesa të tjera	15,517,796	50,000
Shpenzime te periudhave te ardhshme	4,108,188	
Total	84,225,409	14,408,946

7. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor 2010 dhe 2009 përbëhen nga sa më poshtë:

Banka

Emri I Bankes	Monedha	Nr I Llogarise	Vlera ne monedhen Respective	Kursi I kembimit ne fund te vitit	Gjendja ne Lek ne 2010	Gjendja ne Leke ne 2009
Banka Popullore	ALL	126549	23,197,986	1	23,197,986	21,707,110
Banka Popullore	EUR	230566	281	138.77	39,044	13,354,120
Raiffeisen Bank	ALL	119481	1,528,129	1	1,528,129	404,478
Raiffeisen Bank	EUR	119481	720	138.77	99,853	1,192
					-	-
Totali					24865012	35,466,900

Arka

Pershprimi	Monedha	Vlera ne monedhen Respective	Kursi I kembimit ne fund te vitit	Gjendja ne Lek ne 2010	Gjendja ne Leke ne 2009
Arka ALL	ALL	2,378,789	1	2,378,789	122,557
Arka EUR	EUR	71	138.77	9,839	-
Totali				2,388,628	122,557

Mjete monetare dhe ekuivalente me to	27,253,640	35,589,457
--------------------------------------	------------	------------



8. Detyrime financiare

Detyrimet financiare – afatgjata më 31 dhjetor 2010 dhe 2009 përbëhen nga sa më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Borxh afat-gjate – SGS SA(group)	238,376,202	234,531,900
Total	238,376,202	234,531,900

Detyrimet financiare – afatshkurtra më 31 dhjetor 2010 dhe 2009 përbëhen nga sa më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Borxh afat-shkurter - SGS SA (group)	475,625,610	35,922,301
Total	475,625,610	35,922,301

9. Furnitorë dhe detyrime të tjera

Furnitorë dhe detyrime të tjera më 31 dhjetor 2010 dhe 2009 përbëheshin nga sa më poshtë:

	31-Dec-10	31-Dec-09
Furnitorë	39,575,464	40,551,892
Paga dhe leje të zakonshme të pagueshme	7,942,096	10,313
Parapagime	2,854,662	0
Detyrime ndaj palëve të lidhura	2,691,127	1,584,138
Sigurime shoqërore	3,454,716	2,873,227
Tatim ne Burim	95,364	5,625
Tatim Fitimi per tu paguar	1,845,057	
Tatime te tjera	1,000,000	1,026,960
Totali	59,458,486	46,052,155

10. Shitjet

Shitjet nga aktiviteti jane si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009
Sherbimi AUTOMOTIVE	330,865,567	50,494,584
Total	330,865,567	50,494,584



I1. Shpenzime lidhur me përfitimet e punonjësve

Ne 31 dhjetor 2010 kompania ka 112 punonjes, n 2009 kishte 151 punonjes.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009
Paga	98,110,712	19,933,349
Sigurime Shoqerore	14,476,040	2,550,342
Te tjera detyrime	11,043,740	
Total	123,630,492	22,483,691

I2. Shpenzime të përgjithshme dhe administrative

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009
Shpenzime Qeraje	20,847,185	1,709,782
Kosto e Certifikatave	8,089,829	1,637,347
Furnitura dhe Sherbime	56,068,889	16,186,818
Tetefon dhe Energji elektrike	7,701,452	767,129
Detyrime koncensionare	41,270,441	3,780,587
Transport dhe udhetime biznesi	6,866,764	1,210,096
Sigurime	2,478,980	-71,633
Shpenzime marketingu	1,326,023	
Komisione Bankare	734,761	194,880
Te tjera	9,842,598	29,360,328
Total	155,226,921	54,775,332

I3. Shpenzime financiare

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009
Shpenzime per interesa	34,565,405	1,399,561
Te ardhura nga kembimet valutore	-69,666	
Shpenzime per kembime valutore	5,776,708	4,673,716
Total	40,272,447	6,073,277



14. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri vlerësohet në normën e 10% të fitimit të tatueshëm (2008: 10%). Më poshtë paraqitet një rakordim i tatimit mbi fitimin të llogaritur me normën e taksës së aplikueshme me shpenzimin e tatimit mbi fitimin.

	Year ended 31 December		
	Norma e Takses	2010	2009
Humbja para tatimit		-18,838,878	-33,327,522
Shpenzime qe nuk jane te zbritshme per qellime tatimore		55,239,785	884,308
		36,400,907	-32,443,214
Humbja e mbartur		-17,110,339	
Te ardhura te jashtezakonshme Viti 2009			15,332,875
		19,290,568	-17,110,339
Norma e Takses	10%	1,929,057	
Tatimi I Parapaguar		-84,000	-36,000
Tatimi per tu pagua		1,845,057	

15. Ngjarje pas datës së raportimit

Gjate procesit te dorezimit te biznesit ne Shtator – Tetor 2009, sherbimi I kontrollit teknik eshte drejtuar nga DPSHTRR.

Te ardhurat e gjeneruara nga ky sherbim, sipas kontrates se koncensionit, duhet te jene te Shoqerise SGS Automotive Albania, qe nga data efektive e nenshkrimit te kontrates.

Pas bisedimeve dhe mareveshjeve bazuar ne procesverbalin Prot 6050 dt 04/09/09 ne zbatim dhe referim te pikes 8.2.1 te mareveshjes koncensionare dhe procesverbalit Prot 8371 dt 03/12/2010 me te cilin ky institucion na njofton per vleren qe shoqeria do arketoje per rezultatin e ushtrimit per periudhen Shtator - Tetor 2009 vetem ne Dhjetor te 2010.

Parate efektivist kane hyre ne llogari ne Janar 2011, por per efekt taksimi, logariten ne 2010.

16. Shenime

Bazuar ne kontraten e koncensionit, asetet ekzistuese jane marre ne shfrytezim me kontrate uzufukti, rrjedhimisht duhet te jene jashte pasqyrave financiare te shoqerise. Ne 2009 ato kane qene pjese e tyre ndersa ne 2010 do jepet informacion ekstra kontabel me tabela statistikore.

Rivleresim I borxheve ne 2009 eshte klasifikura si rezerva rivleresimi.

Bazuar ne natyren e ketyre borxheve dhe IAS 21, keto efekte duhet te ndikojne rezultatin e ushtrimit, prandaj dhe eshte bere korrigjimi per vitin 2009 ku humbja e raportuar ka qene (27,057,195 ALL) dhe Rezerva e Rivleresimit e ka korrektoar edhe per (6.270,327 ALL) duke e sjelle shifren e humbjes se mbartur ne (33,327,522ALL).



17. Llogari Jashte Bilanci – Aktive te mbajtura per Llogari te te Treteve

Bazuar ne kontraten e koncensionit, shoqeria SGS Automotive Albania, mori ne dorezim asetet ekzistuese te ketij biznesi nga DPSHTRR, me kontratat specifike te Uzu-Fruktit.

Duke qene se keto jane asetete jot e krijuara nga shoqeria dhe perdoren pa nje kundershperblim dhe nuk krijojne shpenzim per perdorimin e tyre, per evidence te organit koncensionardhenes dhe per detyrim kthimi ne fund te afatit te kesaj kontrate, keto asetete mbahen ne llogari jashtet bilanci.

Aktivi

	Shenime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009
Aktive Jashte Bilanci Te mara ne KONCESION	3	147,598,014	161,709,280
> <i>Ndertesa</i>		126,534,660	135,295,082
> <i>Makineri dhe paisje</i>		19,943,287	24,920,775
> <i>Aktive tjera afat gjata materiale</i>		1,120,067	1,493,423

Pasivi

		Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009
Pasive jashte bilanci	3		
> <i>Detyrime ndaj KONCESION DHENESIT</i>		147,598,014	161,709,280

